

Fitimi i shtetësisë nga origjina me njohje

Përshkrimi

Fitimi i shtetësisë me njohje të shtetësisë për persona me origjinë shqiptare

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme;
- 2) Formulari i kërkesës për njohjen e shtetësisë për personin me origjinë shqiptare (tip A);
- 3) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- 4) Certifikatë lindje;
- 5) Certifikatë familjare;
- 6) Dëshmi penaliteti e i legalizuar ose pajisur me vulë apostillë dhe i përkthyer;
- 7) Dokumentacioni mbështetës që vërteton se është pasardhës në vijë të drejtë nga një shtetas shqiptar (deri në tre shkallë) dhe se i paralinduri dhe aplikuesi nuk kanë hequr dorë nga zotërimi i shtetësisë shqiptare,
- 8) Mandat pagesa.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja e dokumentacionit me postë ose personalisht;
- 2) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 3) Përcjellja e dokumentacionit zyrtarisht nga përfaqësia për autoritetet përgjegjëse.

Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro

Në varësi të rregullshmërisë së praktikës, 3 muaj

Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Aplikimet për njohjen e shtetësisë shqiptare janë individuale, veç atyre të shtetasve të mitur, për të cilët shprehen prindërit e tyre. Nuk mund të aplikojnë shtetas të Republikës së Kosovës. Të gjitha dokumentet (të prodhuara në Shqipëri apo në vende të tjera) pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, pa gabime e korrigjime. Të gjitha dokumentet për heqje dorë nga shtetësia sigurohen nga vetë të interesuarit.

Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës

Formularë të nevojshëm:

Formulari i kërkesës për njohjen e shtetësisë shqiptare për personin me origjinë shqiptare

Formulari B